



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

## **Kontrolli Gjyqësor ndaj vendimeve të Agjencisë që krijohen nga procesi i privatizimit dhe likuidimit**

Trajnues:

Ilmi Bajrami , Gjyqtar mbikëqyrës i DHPGJS-së

09 shkurt 2022 Prishtinë

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij moduli është e AD-së, ndërsa pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë

## **Tabela e përmbajtjes**

---

Hyrje .....	4
Objektivat e trajnimit .....	4
Përmbajtja e trajnimit.....	5
Burime dhe literatura .....	5
Kompetencat e AKP-së mbi ndërmarrjet shoqërore .....	5
Fillimi I procesit të likuidimit .....	10
Shitja e aseteve e likuidim .....	14
Kontrolli gjyqësor ndaj vendimeve të AL-së .....	15
Përfundimi I likuidimit .....	<b>Error! Bookmark not defined.8</b>
Raporti përfundimtar.....	<b>Error! Bookmark not defined.8</b>
Kërkesat e DHPGJS-së .....	<b>Error! Bookmark not defined.8</b>
Mbyllja e rastit të ekspedituar.....	<b>Error! Bookmark not defined.9</b>

## **Kontrolli gjyqësor ndaj vendimeve të Agjencisë që krijohen nga procesi i Privatizimit dhe i Likuidimit**

### **Hyrje**

Secili person që kundërshton një vendim a veprim të Agjencisë, duhet ta beje atë brenda aftëve kohore të përcaktuara me ligj. Periudhën kohore për parashtrimin e kërkesës për kundërshtimin e vendimeve apo veprimeve të Agjencisë që dalin nga procesi i privatizimit me herët e ka rregulluara nenin 6 i ligjit paraprak për Dhomës se Posaçme. Në Ligjin aktual dispozita në fjalë nuk ekziston. Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga Autoriteti i Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 35 të këtij ligjit nr.06/L-086 dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi. A duhet që parashtruesi i kërkesës ti shter mjete juridike pran AKP-së, në mënyrë që pastaj ti drejtohet Gjykatës? A është ky një kriter i cili duhet përmbushur në mënyrë që të shkohet tutje apo personat e interesuar që kanë pretendime pronësore apo kreditore ndaj një NSH-je të presin fillimin e likuidimit, në mënyrë që ti drejtohen autoritetit të Likuidimit, apo mund ti drejtohen edhe me herët gjykatës?

Këto dhe dilema tjera të ngritura nga pjesëmarrësit do të trajtohen përmes diskutimeve gjatë trajnimit, rasteve praktike të paraqitura në mënyrë që dilemat e tilla të eliminohen.

### **Objektivat e trajnimit**

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

Njohin procedurën për paraqitjen e kërkesave/ankesave në Dhomën e Posaçme; . Respektojnë afatet kohore për kundërshtimin e vendimeve të Agjencisë; • Zbatojnë drejtë dispozitat ligjore të cilat aplikohen varësisht nga vendimi i kundërshtuar;

Kuptojnë drejtë dhe qartë procedurën e privatizimit dhe likuidimet;

## **Përmbajtja e trajnimit**

Paraqitja e kërkesave/ankesave kreditore dhe pronësore në Komisionin e Likuidimit dhe në Dhomën e Posaçme; Kundërshtimi vendimeve të Agjencisë në Dhomën e Posaçme dhe procedura e shqyrtimit të këtyre vendimeve në dy shkallë,

Metodologjia e trajnimit Diskutime interaktiv me pjesëmarrësit, raste praktike dhe shtjellimi i tyre, prezantimi me PowerPoint

Përfituesit dhe kohëzgjatja Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e Gjykatave themelordivizionit civil, zyrtaret ligjor dhe bashkëpunëtorët profesional. Trajnim do të zgjasë një (1) ditorë.

## **Burimet dhe literatura e përdorur për hartimin temës si dhe literatura shtese që mund të përdoret lidhur me temën.**

*Ligji nr. 06/L-086 për DHPGJS.*

*Ligji nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare e privatizimi Shtojca e tij dhe*

*Ligji në.q4/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë se tyre.*

Ligji mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

Ligji mbi Ndërmarrjet, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 77/78, 40/89, 46/90)

Ligji për letrat me vlerë, me ndryshime (Gazeta Zyrtare e RSFJ 64/89 dhe29/90)

## **Kompetencat e AKP-së mbi ndërmarrjet shoqërore (“NSH”)**

Kompetencat administrative të AKP-së janë të gjera dhe përfshijnë vendosjen nën **Administrimin e drejtpërdrejtë** mbi NSH-të..

Autoriteti i Agjencisë për t’i administruar NSH-të ose asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si një subjekt apo jo të cilat kanë qenë në pronësi shoqërore më 22 mars 1989 ose pas kësaj date, nuk kufizohet në atë se a i janë nënshtruar ato transformimit apo jo. Për më tepër, pa marrë parasysh nëse ndonjë NSH ka pësuar transformim, AKP-ja gjithashtu ka autoritet mbi interesat shoqërore dhe shtetërore në ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik.

Transformimi mund të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë të parapara me nenet 5, 6, 8 dhe 9 të Ligjit AKP-së, duke përfshirë autoritetin për të filluar procedurat e likuidimit, vetëm

kur (i) transformimi bazohet dhe kryhet në përputhje të plotë me ligjin në fuqi, dhe (ii) kur transformimi nuk është as diskriminues e as në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Ligji për AKP, neni 5.4).

Megjithatë, në përputhje me nenin 5.5 të Ligjit të AKP-së, kur është fjala për NSH-në apo asetin që ka pësuar një transformim, Agjencia ka të drejtë të supozojë se transformimi nuk i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 5.4 të Ligjit të AKP-së, përveç nëse Agjencisë i gjinden në dispozicion dëshmi të qarta në bazë të të cilave ajo përfundimisht konstaton se transformimi i plotëson kërkesat e tilla.

Edhe kur një transformim është konstatuar të jetë në përputhje të plotë me ligjin, është shumë e pazakontë që të gjitha aksionet në ndërmarrjen e korporatizuar t'u jenë shitur punëtorëve apo investitorëve. Në shumicën e rasteve, një grup pakicë aksionesh (shpesh pakicë e konsiderueshme në praktikë) do të mbetet në pronësi shoqërore që do të trajtohet përmes realizimit nga Agjencia.

Në rastet kur prova të qarta gjinden në dispozicion të Agjencisë e cila përfundimisht përcakton ndarjen e të drejtave të aksionarëve (ose pronësisë) mbi një ndërmarrje të tillë në mes të kapitalit (ose pronësisë) shoqërore dhe kapitalit ose (pronësisë) private, Agjencia do të pushojë së ushtruari çdo autoritet mbi atë ndërmarrje përveç qëllimit që t'i ushtrojë të gjitha të drejtat aksionare (ose pronësore) që rrjedhin nga pjesa e pronësisë shoqërore të kapitalit të përgjithshëm të ndërmarrjes, ku përfshihet e drejta për të shitur çfarëdo pasurie e cila ka mbetur në pronësi shoqërore.

Kur asetet e NSH-së gjinden jashtë Kosovës, AKP-ja mund t'i ndërmarrë të gjitha ato veprime dhe t'i ushtrojë ato të drejta ashtu siç e parasheh ligji i huaj në lidhje me atë pronë. Megjithatë kur të vendosë mbi çështje të tilla, AKP-ja është e detyruar të marrë parasysh të gjitha politikat përkatëse që mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës. Në të njëjtën kohë, AKP-ja natyrisht do të marrë në konsideratë ligjin që zbatohet në vendet në të cilat mund të gjinden asetet e NSH-së, si dhe mekanizmat në dispozicion të AKP-së të cilat e mundësojnë që procedurat kosovare të njihen në vendin e huaj.

Për t'i bërë ofertat e saja të privatizimit më tërheqëse për investitorët e ardhshëm, AKP-ja ka kompetenca të themelohet ndërmarrje të reja ("**Ndër Re**"), tek të cilat mund të transferohen asetet e NSH-së. Aksionet në këto ndërmarrje të reja - të cilat kanë avantazhin se janë në një masë të madhe të liruara nga borxhi dhe kanë të drejtën e përdorimit të qartë të aseteve - pastaj mund të

shiten, pra duke e lehtësuar privatizimin me të ardhurat që mbahen në mirëbesim për të mirën e NSH-së, të punëtorëve të saj me të drejtë legjitime, të kreditorëve dhe pronarëve të saj.

Në rast se Agjencia ka ushtruar kompetencat e saja për ta shitur biznesin apo asetet e NSH-së, dhe më pas me sukses është vërtetuar pronësia e saj, AKP-ja është e obliguar t'i kompensojë pronarët e tillë nga të ardhurat që rrjedhin nga likuidimi, me kusht që së pari të rregullohet kompensimi i **kërkesave dhe interesave** të kreditorëve **sipas prioritetit**. Është e rëndësishme të kuptojmë se Ligji i AKP-së **Nr. 04/L-034** në mënyrë të qartë parasheh kompensimin e **pronës** e jo kthimin (restituimin).

### **Privatizimi dhe likuidimi- pjesë e procesit**

Shumica e NSH-ve kalojnë nëpër procedurën e privatizimit para se të përzgjidhen për likuidim. Procedura e privatizimit përfshin planifikim të detajuar paraprak që përfshin rishikimin e shitblerjes, zotimet dhe asetet prezente për të prezantuar një biznes të qëndrueshëm që do të jetë tërheqës për investitorët potencialë. Si pasojë e privatizimit, AKP-ja është në dijeni të aseteve që do të mbeten pas privatizimit dhe informacionet e tilla siç janë listat e kreditorëve dhe të të punësuarve mund të nxirren paraprakisht.

Pasi që propozimi për futjen të një NSH -je në likuidim të jetë marrë nga menaxhmenti i Agjencisë, përgatiten Dokumentet e Likuidimit për Bord i cili duhet të përmbaj një përmbledhje për asetet dhe detyrimet. Likuidimi fillon në datën kur Bordi i AKP-së **aprovon dokumentin “Aprovimi i Bordit për Likuidim” me datë e vendimit të Likuidimit**.

Likuidimi është faza e fundit dhe është i projektuar për t'i dhënë fund me shpërndarjen e mjeteve tek kreditorët dhe pronarët; në fund me heqjen e emrit të NSH-së nga Regjistri Kosovar i Shoqërive Tregtare dhe i Emrave Tregtar ("Regjistri i Biznesit"). **Korniza e likuidimit është e projektuar për të lehtësuar realizimin e rregullt të aseteve, identifikimin e kreditorëve dhe shpërndarjen e aseteve në përputhje me parimin e prioritetit të paraparë me nenin 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.**

Në rastin e NSH-ve, AKP-ja administron procedurën e likuidimit duke emëruar **Autoritetet e Likuidimit (AL)**. Bordi i AKP-së cakton një ose më shumë Ofrues të shërbimeve Profesionale (OShP) **të cilët do të shërbejnë në AL** nga fillimi deri në fund të procedurës së likuidimit. Po ashtu, kompetenca të konsiderueshme u janë dhënë edhe DHPGJS-së, p.sh. **shqyrtimi i ankesave**

**ndaj** vendimeve të AL-së, heqja dorë nga aseti, gjykimit të ankesave kundër vendimeve të AL-së ose përmbyllja përfundimtare e likuidimit.

### **Kompetencat e Agjencisë për të likuiduar**

Agjencia mund t'i likuideojë NSH-të apo ndonjë pjesë të tyre nëse mendon se një procedurë e tillë është në interes të kreditorëve dhe/ose pronarëve të tyre. Agjencia duhet ta kryejë likuidimin sipas procedurës së paraparë me Shtojcën e Ligjit për AKP-në . 2011.

Roli i Agjencisë si likuidues 20% e të ardhurave të privatizimit dhe likuidimit (prioritet absolut);

### **E drejta e apelimit**

- Ndaj të gjitha vendimeve të AKP-së në lidhje me privatizimin riorganizimin ose likuidimin e NSH-ve apo çfarëdo çështje tjetër që u përket këtyre do të trajtohen nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës .Supreme të Kosovës **(DHPGJS-se.)**
- Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive neni 5 mbi gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me fushat në vijim:
- kundërshtimi ndaj një vendimi apo ndonjë veprimi tjetër nga AKM-ja apo Agjencia, ndërmarrë në bazë të Rregullores së AKM-së, apo përkatësisht në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
- kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë të cilat rrjedhin nga dështimi apo refuzimi i AKM-së apo Agjencisë për të kryer një akt apo për të përmbushur një obligim që kërkohet me ligj apo kontratë;
- kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë për humbjet financiare që pohohen të jenë shkaktuar nga një vendim a veprim i ndërmarrë nga AKM-ja apo Agjencia, në bazë të autoritetit administrativ të përcaktuar me Rregulloren e AKM-së apo Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në lidhje me një Ndërmarrje apo Korporatë;
- kërkesa kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së, apo Agjencisë.
- kërkesa që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me:



çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ; pronësinë e një Ndërmarrjeje apo Korporate;

pronësinë mbi kapitalin e një Ndërmarrjeje apo Korporate, ose

çfarëdo prone apo pasurie në posedim apo kontroll të një Ndërmarrjeje apo Korporate, nëse një e drejtë, titull apo interes i tillë pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së apo Agjencisë;

- kërkesa apo ankesa që kundërshtojnë apo sfidojnë cilindo aspekt të një liste zyrtare të punëtorëve me të drejtë legjitime të një Ndërmarrjeje, lëshuar nga AKM-ja apo Agjencia, sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo legjislacionit pasardhës që rregullon përpilimin e listave të tilla;
- kërkesa në lidhje me likuidimin e një Ndërmarrjeje, që është kryer nga AKM-ja në bazë të Rregullores së AKM-së, apo nga Agjencia në bazë të Ligjit mbi AKP;
- parashtrësia e bërë nga AKM-ja apo Agjencia në bazë të nenit 21 të Shtojcës A të Ligjit mbi AKP-në, për anulimin e një transaksioni të një Ndërmarrjeje që i është nënshtruar apo që i nënshtrohet likuidimit nga AKM-ja apo Agjencia.
- ushtrimi i të drejtës apo autoritetit të AKM-së apo Agjencisë, nëse AKM-ja apo Agjencia ka parashtruar një parashtrësë në Dhomën e Posaçme për të kërkuar një ushtrim të tillë; rasti apo procedura që del sipas apo brenda fushëveprimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/48 apo legjislacionit pasardhës të saj, apo një ankesë, lëndë, çështje apo procedurë që del apo është në lidhje me një rast sipas apo brenda fushëveprimit të rregullores apo legjislacionit të tillë;
- çdo parashtrësë për vlerësimin dhe vendosjen e ligjshmërisë së një Aktgjykimi apo Aktvendimi të lëshuar nga një gjykatë tjetër në Kosovë në lidhje me kërkesat apo lëndët e përcaktuara.
- shqyrtimi i një vendimi të marrë nga anëtarët ndërkombëtarë të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë për suspendimin e një vendimi të Bordit, në bazë të nenit

Afati për iniciimin e padisë vendimeve të bordit të AKP-së është ai përcaktuar me Ligjin mbi Procedure Administrative 30 dite.

## **Fillimi i procesit te likuidimit**

Përzgjedhja e NSH-së për likuidim, **Informimi i Bordit**

### ***Fillimi i likuidimit***

Procesi i likuidimit konsiderohet si i filluar që nga data e vendimit mbi likuidim. Menjëherë publikohet njoftimi për likuidim . Informohet edhe DHPGJS-dhe Gjykatat tjera qëllimi i të cilës është pezullimi I procedurave gjyqësore ndaj NSH\_së në Likuidim .

Njoftimi publik për likuidim

**Udhëzimet nga DHPGJS** AL mund t'i drejtohet DHPGJS-së me kërkesë me shkrim për gjykim të ndonjë çështje në ligj dhe DHPGJS-ja duhet të vendos për këtë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë pune.

DHPGJS mund të jap urdhër, proces, apo **aktgjykim** që është i arsyeshëm dhe i **domosdoshëm** apo i përshtatshëm për **t'i zbatuar** dispozitat e ligjit në fuqi apo për të ndihmuar likuidimin e ndonjë Ndërmarrje..

Brenda 10 ditëve **të punës** nga data e vendimit për Likuidim për emërimin e tij, AL do të publikojë Njoftimin për Likuidim në përputhje me dispozitat për shpallje:

Brenda 15 ditëve pas publikimit fillestarë të Njoftimit për Likuidim, AL përsëri do të publikojë njoftimin me përmbajtje të njëjtë, siç është cekur më poshtë, për të gjithë kreditorët dhe pronarët e NSH-së :

- a) Që të gjithë personat e interesuar për të parashtruar kërkesë në apo kundër NSH-së apo ndonjë nga asetet e saja duhet të parashtrojnë Dëshmi të Kërkesë dhe/ose Dëshmi të Interesit së bashku me tërë dokumentacionin e kërkuar brenda Afatit për Parashtrimin e Kërkesë, që do të jetë në ditë pune që është 45d ditë pas datës së publikimit të Njoftimit për Likuidim;
- b) Që të gjithë Personat që pretendojnë që kanë Kërkesa apo Interese në apo kundër NSH-së apo ndonjë Aset të NSH-së duhet të parashtrojnë Kërkesën, pavarësisht nëse më herët kanë informuar Gjykatën, Agjencinë apo paraardhësin e Agjencisë (Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit);

- c) Që të gjitha Kërkesat dhe Interesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të duhur sipas afatit për paraqitjen e Kërkesës do të refuzohen dhe të **jenë** përgjithmonë të **parashkruara dhe të pa ekzekutueshme** ; dhe
- d) Ku dhe si një person mund të marr formularin standard dhe udhëzimet për parashtrimin e Dëshmisë për Kërkesë dhe Dëshmi të Interesit.

### **Pezullimi i të gjitha veprimeve ligjore**

AL do të aplikojë për pezullimin e veprimeve ligjore kundër NSH-se përderisa këto veprime janë iniciuar nga ndonjë Gjykatë në Kosovë. Kur të kërkohet një gjë e tillë në Gjykatë, AL do të sigurojë informatat e kërkuara sipas Shtojcës të Ligjit të AKP-së./.

### **Përgjegjësit dhe autorizimet e AL.**

AL do të sigurohet që inventari i aseteve dhe diagrami fillestar i borxheve të NSH-së të jetë në dispozicion për inspektim publik për së paku tetë (8) orë në ditë për pesë (5) ditë pune para shitjes së aseteve. AL do të vë informatat e tilla në dispozicion në faqen elektronike të Agjencisë, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

AL rregullisht do të azhurnojë diagramin e borxheve sipas regjistrimit të kërkesave të reja të kreditorëve. Kjo informatë shpallet në dy mënyra: një përmes njoftimit të shpallur për të gjithë kreditorët dhe nëpërmjet shpalljes në faqen elektronike të AKP-së.

Autoriteti i Likuidimit, me leje të Gjykatës, mund të heq dorë apo në mënyra tjera të zgjidh cilindo nga asetet e ndërmarrjes ,aset problematik apo joprofitabil.çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e ndërmarrjes, Autoritetit të Likuidimit apo Gjykatës.

Gjykata nxjerr vendim lidhur me kërkesën për lejim të dorëzuar nga Autoriteti i Likuidimit më lart jo më vonë se dyzetepesë (45) pas datës në të cilën është dorëzuar kërkesa në Gjykatë dhe një kopje e saj t'i jetë dorëzuar Komitetit të Kreditorëve (nëse është themeluar nga Autoriteti i Likuidimit) dhe palët e tjera sipas udhëzimeve të Gjykatës.

Çdo palë që kundërshton një kërkesë të tillë duhet të parashtojë kërkesë për prapësim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas ta kenë pranuar kërkesën. Autoriteti i likuidimit i ka pesëmbëdhjetë (15) ditë për t'iu përgjigjur shkresave të tilla të kundërshtimit pasi ta ketë pranuar një të tillë.

Gjithashtu menjëherë pas datës së Vendimit për likuidim, Autoriteti i Likuidimit lëshon njoftim për palët e treta që mbajnë apo kanë në posedim asete të ndërmarrjes duke kërkuar që ajo palë e tretë të ndërpresë posedimin dhe të dorëzojë asetin te Autoriteti i Likuidimit.

Kurdo që është e nevojshme, Autoriteti i Likuidimit, në emër të Agjencisë, kërkon nga Gjykata urdhër për zbatimin e kësaj kërkesë.

Nëse aseti në fjalë gjendet jashtë Kosovës, Autoriteti i Likuidimit mund të kërkojë nga një gjykatë tjetër që ka juridiksion mbi asetin dhe autoritet të zbatojë këtë kërkesë, apo Autoriteti i Likuidimit mund të kërkojë që Gjykata të lëshojë kërkesë për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar sipas paragrafit 2 të nenit 19 të rregullores së punës të Gjykatës, të përshkruar në Shtojcën e Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Nëse zbatimi i kësaj kërkesë dëshmohej të jetë i pasigurt, jopraktik apo jo i shpejtë, Autoriteti i Likuidimit mund të parashtojë kërkesë me shkrim në Gjykatë, sipas paragrafit nenit 19, për autoritetin për të hequr dorë apo zgjidhur në mënyra tjera interesin e ndërmarrjes ndaj asetit. 4. Nëse prona e ndërmarrjes gjendet në shtete tjera dhe nuk mund të realizohet, Autoriteti i Likuidimit kërkon nga Gjykata leje për të hequr dorë nga kjo pronë.

Agjencia krijon regjistër të pronave të hequra dorë dhe këtë pronë e dorëzon te Shteti i Kosovës që të mbahet në mirëbesim. Nëse një pronë e ndërmarrjes në shtetet tjera realizohet nga qeveria e Kosovës, të hyrat nga ajo shitje e pronës do të transferohet te Agjencia për t'iu mbajtur në mirëbesim për përfitim të përgjithshëm të kreditorëve të regjistruar dhe bartësve të regjistruar të interesit në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Për këtë qëllim, Autoriteti i Likuidimit mban regjistër të pronave të hequra dorë të ndërmarrjes dhe ekstrakti i këtij regjistri do t'i bashkëngjitet raportit final të Autoritetit të Likuidimit në mbyllje të rast.

Gjykata nxjerr vendim lidhur me çdo kërkesë të dorëzuar nga Autoriteti i Likuidimit jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është dorëzuar kërkesa në Gjykatë dhe një kopje e saj t'jetë dorëzuar Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston)

dhe palëve të tjera sipas udhëzimit nga Gjykata. Çdo palë që kundërshton kërkesat e tilla duhet të parashtojë kërkesë për prapësim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi ta ketë marrë kërkesën. Autoriteti i Likuidimit i ka pesëmbëdhjetë (15) ditë të përgjigjet në shkresën e kundërshtimit pasi ta ketë pranuar të njëjtën.

#### Anulimi i Transaksioneve

- Me kërkesë të AL, Gjykata nxjerr urdhër për anulimin e çdo transferi, transaksioni apo kontrate që përfshin apo prek asetet apo kapitalin e ndërmarrjes të fituar gjatë periudhës 22 mars 1989 deri në datën e Vendimit nëse transfer, transaksion apo kontratë, apo pagesat apo furnizimet janë bërë në vlerë më të vogël
- kanë ulur vlerën totale të aseteve të ndërmarrjes dhe kishin për qëllim apo për pasojë dëmtimin e interesave të kreditorëve;
- kishin qëllim apo rezultuan në humbje, zvarritje apo pengim të aftësisë së kreditorëve për të mbledhur kërkesa përmes transferimit të aseteve të palë të treta gjersa pala e tretë ishte apo duhej të ishte në dijeni
- ishin si rrjedhojë e një transaksioni me kreditorin, përmes së cilit kreditori ka fituar më tepër se sesa hisja proporcionale në asetet e ndërmarrjes dhe transaksioni ka ndodhur në kohë kur kreditori duhej të ishte në dijeni se ndërmarrja nuk ishte apo nuk do të ishte në gjendje t'i përmbush obligimet e saj;
- ishin në kundërshtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së apo Rregulloret e Këshillit të Bashkimit Evropian lidhur me imponimin e sanksioneve ndërkombëtare, pavarësisht se ajo mund të jetë pranuar më vonë me vendim gjyqësor apo arbitrim;
- kanë qenë të prira për t'u anuluar apo të qenë të pazbatueshme në bazë të dispozitave të nenit 36 apo një baze tjetër ligjore.
- Transferimi për qëllim të këtij neni përfshin çfarëdo mënyre (direkte apo indirekte, absolute apo të kushtëzuar, vullnetare apo jovullnetare) të bartjes ose transferit, shitjes, këmbimit, dhuratës, shpërndarjes, zgjidhjes, lënies peng, hipotekës apo të drejtave të tjera.
- Gjykata nxjerr vendim për kërkesat e dorëzuara sipas paragrafit jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë pas datës në të cilën është dorëzuar

kërkesa në Gjykatë dhe një kopje e saj t'jetë dorëzuar Komitetit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve të tjera sipas udhëzimit nga Gjykata.

Çdo palë që kundërshton kërkesat e tilla duhet të parashtrojë kërkesë për prapësim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi ta kenë marrë kërkesën. Pala që dorëzon kërkesën i ka pesëmbëdhjetë (15) ditë të përgjigjet në shkresën e kundërshtimi

### **Shitja e aseteve me likuidim**

Ekziston ndarja e qartë e përgjegjësi ndërmjet AL dhe Agjencisë në procesin e shitjes së aseteve me likuidim. Autoriteti i Likuidimit do të ketë përgjegjësi për propozimin e realizimit (shitjes) së Aseteve të NSH-së dhe Agjencia, nëpërmjet Departamentit të Shitjes do të organizojë dhe menaxhojë shitjen e aseteve të NSH-së në Likuidim.

AL ka për obligim që brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga publikimi i parë i Njoftimit për Likuidim të përgatis inventarin e të gjitha aseteve të NSH-së dhe të propozojë menaxhmentit shitjen qoftë individuale apo të grupuar të aseteve të NSH-së. Autoriteti i Likuidimit do të ofroj arsyetimin pse asetet e NSH-së duhet të shiten në **grupe** apo asete individuale.

Agjencia do të vendos si të klasifikojë ("Caktimi i Prioritetit") shitjet me likuidim të aseteve të NSH-së, individualisht ose grupore. Gjatë kësaj, Agjencia mund të shqyrtojë asetet individuale dhe/apo grupor, të cilët kanë asete, për të cilat janë lajmëruar investitorët dhe kanë shprehur interesim për blerje, për tu klasifikuar me prioritet të lart për shitje.

Sipas rastit, AL mund t'i propozoj Menaxhmentit shitjen e aseteve të caktuara të NSH-së me negociata të drejtpërdrejta si mënyra më reale e shitjes të aseteve apo nëse është e qartë nga faktet që shitja me tender nuk do të ketë sukses për shkak të rrethanave të rastit.

### **Caktimi i prioritetit të kërkesave**

Prioriteti i kërkesave **dhe interesave** të cekura në **listën** e borxheve të NSH-së duhet të përllorarit në përputhje me Shtojcën 1 të Ligjit të AKP-së neni 40.

### **Lista përfundimtare e kërkesave**

Sipas Shtojcës së Ligjit të AKP-së, neni 39, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas vlerësimit të të gjitha kërkesave duke përfshirë përcaktimin e kundërshtimeve ndaj vendimit të AL nga kreditorët

e prekur lidhur me kundërshtimin apo zvogëlimin e kërkesave, AL do të përpiloj listën përfundimtare të kërkesave duke cekur shumën e tyre dhe statusin në përputhje me kategoritë e prioritetit të cekura në Shtojcën 1 të Ligjit të AKP-së, nenin 40.

Lista përfundimtare e kërkesave duhet të vendoset në faqen elektronike të Agjencisë brenda 30 ditëve nga përfundimi i vlerësimit të kërkesave (**Shtojca** e Ligjit të AKP-së, nenet 39.1 dhe 39.2).

### **Kontrolli gjyqësor ndaj vendimeve të AL-së**

Shqyrtimi i vendimeve të Autoritetit për likuidim 1. Procedura para Dhomës së Posaçme për kundërshtimin e vendimit të një Autoriteti të Likuidimit që është duke kryer likuidimin e një ndërmarrje ose asetit sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të rregullohet në bazë të këtij neni. 2. Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendim i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2 të nenit 35 të këtij ligji dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi. 3. Në shkallë të parë, zhvillimi i lëndës apo procedurës lidhur me ankesa të tilla do t'i caktohet Gjyqtarit të vetëm sipas rregullave të përcaktuara për shpërndarjen dhe caktimin e lëndëve. 4. Dispozitat e tjera të përgjithshme procedurale në nenet 22-63 të këtij ligji zbatohen për lëndët dhe procedurat bazuar në ankesa të tilla. Gjyqtari i vetëm apo aty kur është e zbatueshme

### **Vlerësimi dhe vendimi i AL-së në kërkesa**

Menjëherë pas afatit për parashtrimin e kërkesave, AL do të vlerësojë validitetin, dhe baza e kërkesave dhe do të njoftojë pretenduesit për rezultatet e vlerësimit. Nëse kërkesat nuk janë të plota apo dëshmitë kanë mungesa, AL mund të kërkojë informatat dhe dëshmitë shtesë në afat prej 15 ditëve sipas pikës 7.7.7 të Politikave Operacionale të AKP-së. Më pas, nëse AL, refuzon, tërësisht apo pjesërisht, apo zvogëlon shumën e kërkesës së parashtruar, do të njoftojë kreditorët me shkrim, duke dhënë shpjegimin për refuzimin apo zvogëlimin e kërkesës.

Sipas nenit 7.7.5 të Politikave Operuese të AKP-së, vlerësimi i validitetit të secilës kërkesë do të ndodh brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi dhe kërkuetit do të njoftohen brenda pesë (5) ditësh nga vlerësimi nëse kërkesa është përfshirë në diagramin e borxheve të NSH-së

### **Trajtimi i kërkesave**

#### *Afati i parashtrimit të kërkesës*

Afati për parashtrimin e kërkesave është përcaktuar në nenin 7 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë një ditë pune, dyzet e pesë ditë (45) pas datës së publikimit të njoftimit të bërë nga Autoriteti i Likuidimit në pajtim me dispozitat për shpallje duke u bërë thirrje të gjithë kreditorëve dhe ankesat kundër kërkesave të refuzuara

Gjatë punës së vet AL-ja mund t'i refuzoj **kërkesat** në tërësi apo pjesërisht, apo zvogëloj shumën e kërkesës së kreditorit për të cilën duhet ta njoftoj kreditorin. Kreditori i pakënaqur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit mund të apeloj një vendim të tillë në DHPGJS brenda 30 ditëve pas pranimit të vendimit, në qoftë se kreditori dështon ta parashtrij ankesën e tij brenda afatit të duhur atij i pamundësohet kundërshtimi i vendimit të AL-së.

#### *Ankesat kundër vendimeve të AL-së*

Të gjitha vendimet e Autoritetit të Likuidimit pala e pakënaqur mund ti apeloj në DHPGJS të Kosovës. Neni 71 Nëse Autoriteti i Likuidimit refuzon tërësisht apo pjesërisht, ose zvogëlon vlerën e kërkesës së parashtruar, ajo duhet të njoftoj me shkrim kreditorin e prekur, duke i dhënë sqarim për refuzimin apo zvogëlimin e kërkesës.

Kreditori i prekur ka të drejtë që të aplikoj në Dhomën e Posaçme në afatin prej 30 ditësh prej datës së njoftimit me vendimin e Autoritetit të Likuidimit për përcaktimin e kërkesës së tij dhe në rast të dështimit të parashtrimit në kohë, kreditori nuk do të ketë mundësi të kundërshtoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Gjykata do të sjell vendim për kërkesën e parashtruar nga kreditori i prekur jo më vonë se 45 ditë pas datës së parashtrimit të kërkesës në Gjykatë dhe një kopje i sigurohet Autoritetit të Likuidimit, Komisionit të Kreditorëve (nëse ekziston) dhe palëve tjera sipas udhëzimit të Gjykatës.



Procedura para Dhomës së Posaçme për kundërshtimin e vendimit të një Autoriteti të Likuidimit që është duke kryer likuidimin e një ndërmarrje ose asetit sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit do të rregullohet në bazë të këtij neni.

Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2 të nenit 35 të këtij ligji dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi. Në shkallë të parë, zhvillimi i lëndës apo procedurës lidhur me ankesa të tilla do t'i caktohet Gjyqtarit të vetëm sipas rregullave të përcaktuara për shpërndarjen dhe caktimin e lëndëve.

Dispozitat e tjera të përgjithshme procedurale në nenet 22-63 të këtij ligji zbatohen për lëndët dhe procedurat bazuar në ankesa të tilla. Gjyqtari i vetëm apo aty kur është e zbatueshme

### **Shpërndarja e të ardhurave nga shitja e aseteve**

AL ka përgjegjësi për t'i rekomanduar Bordit të AKP-së shpërndarjen e parakohshme dhe përfundimtare.

### **Përfundimi i likuidimit**

Brenda tridhjetë (30) ditëve nga Shpërndarja përfundimtare apo pasi të shpërndahen të gjitha fondet, AL do të kërkojë aprovimin e Bordit për Raportin Final. Raporti i aprovuar final do t'i dorëzohet Gjykatës (DHPGJS).

### ***Raporti përfundimtar***

Brenda 30 ditëve pas shpërndarjes përfundimtare ose menjëherë kur të gjitha fondet janë realizuar dhe shpërndarë, AL përgatit raport për Bord me të cilin kërkon aprovimin e raporti final i cili do të dorëzohet në DHPGJS në pajtim me nenin 43 **Shtojca** e Ligjit për AKP-në.

**Raporti përfundimtar i Autoritetit të Likuidimit duhet të përmbaj të gjitha të dhënat konform nenit 43.2 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë dhe nenit 7.14.2 .**

- i) Një listë e të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera; iNjë listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme;
- ii) Një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara, duke shënuar në mënyrë të qartë shumat e shpërndara apo pronën e transferuar për përmbushjen e tërësishme apo pjeseshme të secilës;

**Një listë të bilancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim .**

### ***Kërkesat në DHPGJS***

Me qëllim të miratimit nga ana e Bordit të AKP-së, AL përgatitë një raport përfundimtar i cili paraqet hollësisht të gjitha çështjet relevante që kanë ndodhur që nga marrja e vendimit nga Agjencia për të filluar procedurën e likuidimit për NSH-në.

DHPGJS pas pranimit të raportit përfundimtar dhe parashtrimit të kërkesës për përmbyllje, brenda **pesëmbëdhjetë (15)** ditësh nxjerr një urdhër të shkruar për mbylljen e procesit të likuidimit nëse është përmbushur ashtu që e gjithë prona dhe asetet e NSH-së janë likuiduar.

. Nëse DHPGJS e kundërshton Raportin Final atëherë AL përgjigjet në kundërshtim dhe e dorëzon atë në Gjykatë brenda 30 ditëve pas mocionit të gjykatës apo brenda kohës së cekur në udhëzimin nga DHPGJS-ja.

DHPGJS-ja shënon në çdo urdhër dispozitën për përmbylljen e procedurës së Likuidimit për lirim të AL ndaj ndonjë obligimi të mëtutjeshëm në lidhje me NSH-në dhe me procedurat e likuidimit.

Duhet të theksohet se Gjykata sipas detyrës zyrtare, pas shqyrtimit mund të kundërshtojë Raportin Përfundimtar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të dorëzimit. Nëse dërgohet njoftimi për kundërshtim, Autoriteti i Likuidimit përgjigjet në kundërshtim dhe e dorëzon atë në Gjykatë

brenda tridhjetë (30) ditëve pas mocionit të gjykatës apo brenda kohës së cekur në udhëzimin nga Gjykata.

***Mbyllja e rastit të ekspedituar***

Me kërkesë të Autoritetit të Likuidimit, në çdo fazë të procedurës, nëse përcaktohet se të hyrat në fjalë janë të pamjaftueshme për të mbuluar kostot e Kërkesave prioritare të përcaktuara në Ligjin e AKP-së **Shtojca**, neni 40, paragrafi (1), nënparagrafi 1),

Gjykata nxjerr vendim për lejimin për mbylljen e rastit të likuidim.

GJM.